



THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë dhe therrjet e raportuara të gjedhit për gjashtëmujorin e dytë 2019

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të vazhdojë të mbështesë sektorin e blegtorisë përmes pagesave direkte për qumësht/litër dhe therrjet e raportuara të gjedhit.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët / aplikuesit që aplikojnë për Pagesa Direkte – qumësht sipas kategorive të cilësisë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (personat juridik);
- Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe të Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Ta kenë kontratën për shitjen e qumështit me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështorët e licencuara në Kosovë;
- Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laboratorit i AUV-së për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën grumbulluese të qumështit, i pranueshëm për pagesë është qumështi i kategorive: Ekstra, Klasi i Parë dhe i Klasi i Dytë;
- T'i dorëzojë së paku 3000 litra qumësht për 6 (gjashtë) mujorin e dytë të vitit kalendarik;
- Të ofrojnë dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës (për personat fizik) ose kopjen e regjistrimit të biznesit (për persona juridik);
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e listës së verifikimit të kafshëve: gjedhet, dhentë dhe dhitë të lëshuar nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I&R) në kuadër të AUV-së;
- Kopjen e kontratës për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose nga pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Dëshminë për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose në pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të pikës grumbulluese dhe kopja e kontratës së pikës grumbulluese me ndonjërin nga qumështoret e licencuara;
- Dëshminë nga banka për pagesën e bërë nga qumështorja për sasinë e dorëzuar;
- Dëshminë nga AUV për cilësinë e qumështit të dorëzuar;
- Dëshminë për pjesëmarrjen në projektin “Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit”;
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

Mënyra subvencionimit:

Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar në qumështore të licencuar ose në pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë, sipas kategorive:

- 1. Ekstra klasë 0.06 €**
- 2. Klasa e Parë 0.04 €**
- 3. Klasa e Dytë 0.02 €**

Kriteret që duhet t'i plotësojnë aplikuesit/therrtoret që aplikojnë për Pagesa Direkte – therrjet e raportuara të gjedhit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të licencuara nga AUV në kategorinë A, B, C dhe D;
- Të raportojnë therrjet në bazën e të dhënave në Sektorin e Identifikimit dhe Regjistrimit në AUV, sipas dinamikës së paraparë të thertores;
- Gjedhet duhet të jenë të matrikulluara me matrikull të Republikës së Kosovës.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit/subjektit;
- Kopjen e licencës së lëshuar nga AUV-ja;
- Kopjen e certifikatës së biznesit dhe informatat e biznesit;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshminë/vërtetimin për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Regjistrin e kafshëve të therura, të lëshuar nga baza e të dhënave të sektorit të Identifikimit dhe Regjistrimit-AUV, të dëshmuar me pasaportën e kafshës së theruar;
- Dëshminë/fletëpagesën, me të cilën vërtetohet se është realizuar pagesa nga thertorja tek fermeri, në vlerë prej 30 €/krer gjedhit të therur.

Mënyra e subvencionimit:

- Pagesa do të bëhet për krerë gjedhe të therur, në vlerë prej 50 €/krer;
- Pagesës në vlerë prej 50 euro/krer u bëhet thertoreve përfituese;
- Thertoret obligohen që vlerën e mjeteve prej 30 euro t'ia paguajnë fermerit në momentin e therjes së gjedhit. Ndërsa, vlera e mjeteve prej 20 euro i mbetet thertores për shërbimin e therjes.

Mënyra e aplikimit:

Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale për Bujqësi; Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për Pagesat Direkte në lëmin e bujqësisë.

Përiudha e aplikimit: Afati i aplikimit fillon nga data 15.01.2020 dhe mbaron me datë 15.02.2020.